

R A P O R T I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

Une I quajturi Volf Semini Ekspert Kontabel I Autorizuar,i ngarkuar nga asambleja e ortakeve te shoqerise "I.A.M. sh.p.k. Durres per vertetimin e kontributeve financiare dhe kontabilizimin e mjeteve financiare,per zmadhimin e kapitalit te nenshkruar te shoqerise,paraqes raportin si me poshte:

Me vendimin nr.21044 date 16.03.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane,eshte pranuar themelimi I shoqerise "I.A.M. sh.p.k. Durres me seli ne Xhafzotaj-Shijak-Durres dhe ka te regjistruar nje kapital te nenshkruar prej 100.000 lek

Me vendimin Nr 2 date 29/06/2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise,pas analizes se treguesve financiare te paraqitura ne bilancin e vitit 2004,kane vendosur qe fitimet e trasheguara nga vitet e kaluara ne shumen 20.390.230 lek dhe fitimi I vitit 2004 ne shumen 21.688.460 leke,te perdoren si vijon:

- 1.Per zmadhimin e kapitalit te nenshkruar me 25.000.000 leke
- 2.Per zmadhimin e rezerves ligjore me 2.450.000 leke
- 3.Per zmadhimin e rezervave te tjera me 14.628.690 leke

Pas zmadhimit te kapitalit shoqeria I.A.M. sh.p.k. Durres ka nje kapital te nenshkruar si me poshte:

- Kapitali i nenshkruar deri me 31.12.2004 100.000 leke
- Zmadhimi i tij sipas vendimit Nr 2 dt. 29.06.2005 25.000.000 leke
- Kapitali i nenshkruar i shoqerise pas zmadhimit behet 25.100.000 leke

Nga verifikimet e kryera konstatoj se jane respektuar kerkesat e Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare",vecanerisht nenet 61,62 e ne vijim si dhe Statuti I shoqerise per zmadhimin e kapitalit te nenshkruar.

Me ndryshimet e mesiperme te kapitalit,perqindjet e pjesmarrjes se ortakeve ne kapitalin e nenshkruar nuk pesojne ndryshime.

Ne perfundim vertetoj qe kapitali I nenshkruar I shoqerise I percaktuar si me siper,mbulohet dhe I pergjigjet vleres se aktiveve neto te kesaj shoqerie.

Durres me 08/07/2005

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Volf SEMINI


VOLF SEMINI
EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
DURRES

21044/3


KERKESE

15

KORIK 2005

J. Blevine Muga

15 02 2005



Kerkuesit: 1. Ilir Muhamed Ndraxhi, i dtl. 28.01.1964, banues ne Xhafzotaj, Durres, me cilesine e administratorit dhe ortakut te shoqerise tregtare "I.A.M." Sh.p.k. dhe
2. Muhamed Riza Ndraxhi, i dtl. 16.03.1939, banues ne Xhafzotaj, Durres, me cilesine e ortakut te Shoqerise "I.A.M." Sh.p.k.

Objekti: Depozitimin e Vendimit nr. 3 dt. 12.07.2005 te Asamblese se ortakeve te shoqerise "I.A.M." Sh.p.k. dhe te Raportit te ekspertit kontabel te autorizuar Volf Semini, prane Regjistrat Tregtar te Gjykates se shkalles se pare Tirane, qe ka sjelle ndryshimin e neneve 8 dhe 9 te Statutit te shoqerise.

Baza Ligjore: Ligji nr. 7632 date 04.11.1992, Ligji nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

Per depozitimin ket

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE!

kerkesa dt

19.7.05

Shoqeria tregtare "I.A.M." Sh.p.k. eshte regjistruar prane regjistrat Tregtar me vendimin nr. 21044 date 16.03.1999 te Gjykates se Rrethit Tirane, sipas te cilit kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100 000 leke, nga ku ortakët Ilir Ndraxhi dhe Muhamed Ndraxhi zoterojne secili 50% te kuotave, ose 50 pjese secila me vlerë nominale te kuotave prej 1000 leke secila.

Me vendimin n. 21044/2 te Gjykates shkalles pare Tirane eshte vendosur:

*Depozitimi i vendimit nr. 2 date 29.06.2005 i Asamblese se ortakeve te shoqerise "I.A.M" shpk, i cili kishte vendosur:

1. Miratimin e llogarive vjetore te shoqerise Tregtare "I.A.M." Sh.p.k. per vitin financiar 2004 (1 Janar - 31 Dhjetor 2004)

2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "I.A.M." Sh.p.k., me fitimet e pashperndara nga vitet e kaluara dhe fitimin e vitit 2004;

3. Te caktoje z. Volf Semini, anetar te IEKA-s, me profesion Ekspert Kontabel i Autorizuar, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me fitimet e pashperndara nga vitet e kaluara dhe fitimin e vitit 2004;

Vendim Nr 2 dt 29.6.05

B. Oleskeir

Raport Ekspertim

6.7.05